REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
SKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

PROJEKT – VENDIM

Nr. 41 datë 24 . 6 2025

PËR

MIRATIMIN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI SUBVENCIONI I INTERESAVE TË KREDISË PËR STREHIM

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*" i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, VKM nr.384, datë 12.6.2019 "*Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore*", VKM nr. 453, datë 03.07.2019 "*Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet, që përfitojnë banesë me kosto të ulët , me kredi të lehtësuara nga shteti*", VKM nr.301 datë 15.4.2020 "*Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët*", VKB Nr.17, datë 27.02.2025 "*Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit*",nivelit minimal dhe maksimalte te te ardhurave dhe dokumentacionit kredi te lehtesuar nga shteti qe duhet te plotesojne individet/familjet per tu trajtuar me programin e subvencionimit. VKB nr.2 datë 29.01.2025 për "*Miratimin e rregullores dhe funksionimin e komisionit te strehimit strehimit në bashkinë Devoll*" , Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.37 datë 25.01.2024"*Për ngritjen e komisionit të strehimit pranë bashkisë Devoll*

PROPOZOJMË:

1. Të miratojë listen me aplikues Znj/ Elona Emin Uzhuri ,Z/ Mikel Hekuran Ahmetli të cilët u përzgjodhen nga Komisioni i Strehimit si kategori përfitues në programin "Subvencioni i Interesave të Kredisë" sipas tabelës Nr. 2 bashkëngjitur këtij Projekt-Vendimi dhe vendimit te komisionit date 23.06.2025

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Kujdesit Social , Bashkia Devoll
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" i ndryshuar

Konceptoi: Sp.e Admi të Nevojave për Strehim
L.Laçi
Konfirmoi: Dr.Sherbimit Social
Z.Sinani
Konfirmoi bazën ligjore:
Përgj. Sek Juridik
Eriksela Avdo

KRYETAR I BASHKISË

EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · BASHKIA DEVOLL

Adresa: Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; web: http://bashkiadevoll.gov.al/

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
SKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

Nr. 2074 Prot Date: 26.06.20

RELACION
Mbi Projekt-Vendimin
PËR
MIRATIMIN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI SUBVENCIONI I INTERESAVE TË KREDISË PËR STREHIM

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*" i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, VKM nr.384, datë 12.6.2019 "*Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore*", VKM nr. 453, datë 03.07.2019 "*Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet, që përfitojnë banesë me kosto të ulët , me kredi të lehtësuara nga shteti*", VKM nr.301 datë 15.4.2020 "*Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët*", VKB Nr.17, datë 27.02.2025 "*Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit*",nivelit minimal dhe maksimalte te te ardhurave dhe dokumentacionit kredi te lehtesuar nga shteti qe duhet te plotesojne individet/familjet per tu trajtuar me programin e subvencionimit. VKB nr.2 datë 29.01.2025 për "*Miratimin e rregullores dhe funksionimin e komisionit te strehimit strehimit në bashkinë Devoll*" , Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.37 datë 25.01.2024"*Për ngritjen e komisionit të strehimit pranë bashkisë Devoll*"

Bazuar Nenit 48 i ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*" i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023 përfituesit nga programi i banesave me kosto të ulët:
Familjet të cilat në kohën e paraqitjes së kërkesës pranë strukturës përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore:
a) vërtetojnë se nuk kanë banesë ose nuk kanë kryer asnjë transaksion për tjetërsimin e pronësisë, të paktën në 5 vjetët e fundit, përveç rastit kur pronësia mbi to ka humbur për shkak të një fatkeqësie (vdekjeje apo sëmundjeje të rëndë) ose force madhore;
b) zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit;
c) janë të zhvendosura nga banesat sipas parashikimeve në nenin 6 të këtij ligji.
2. Kur përfitues është një familje që ka siguruar banesë nëpërmjet programeve sociale nga procesi i privatizimit ose nëpërmjet blerjes në tregun e lirë dhe sipërfaqja e banimit është nën normat e strehimit, bëhet shkëmbimi i banesës nën normë për të marrë një banesë në normat e nevojshme të

strehimit, duke u llogaritur diferenca ndërmjet vlerës së banesës ekzistuese me vlerën e banesës me kosto të ulët që merr. Banesa ekzistuese nën normë bëhet pjesë e fondit publik të banesave dhe vihet në dispozicion të programit të banesave me kosto të ulët.
2/1. Familjet, që disponojnë banesë në pronësi nën normat e strehimit dhe paraqesin kërkesë për strehim, përfitojnë kredi me interesa të subvencionuara sipas nenit 47 të këtij ligji, në masën jo më të madhe se 60% e çmimit mesatar të shitblerjes së banesës në treg, që miratohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave, sipas shkronjës "dh" të nenit 72 të këtij ligji.
3. Normat e strehimit, sipas shkronjës "b", të pikës 1, të këtij neni, edhe procedura e shkëmbimit të banesës me kosto të ulët, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Administrimi i kërkesave për këto banesa bëhet nga strukturat përkatëse të njësive të vetëqeverisjes vendore.
Bazuar pikës 3 të Vendimit nr.301, datë 15.4.2020 "*Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për Banesat Sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me Kosto të Ulët*"
Norma e strehimit për programet e strehimit social, në përputhje me parimet e politikave të strehimit, bazuar në nenet 3 deri 10, të ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social", është 30 m2 sipërfaqe neto për personin e parë. Për çdo person shtesë, sipërfaqja neto shtohet me 10m2 dhe llogaritet sipas formulës më poshtë:
Sipërfaqja Neto e Banesës = 20m2 + N x 10 m2 Ku: Sipërfaqja neto e banesës: është sipërfaqja e shfrytëzimit pa muret e brendshme dhe
perimetralë, e quajtur ndryshe si sipërfaqja e përdorshme ose e shkeljes.
N është numri i banorëve mbi moshën 5 (pesë) vjeç.
4. Kur në përbërje të familjes ka një a më shumë persona me aftësi të kufizuara, norma e strehimit për personin e parë është 40m2. Për çdo person shtesë, sipërfaqja neto shtohet me 10m2 dhe llogaritet sipas formulës:
Sipërfaqja Neto e Banesës = 30m2 + N x 10m2
Ku: 'Sipërfaqja neto e banesës' dhe 'N' kanë kuptimin si në pikën 3 të këtij vendimi.

Komisioni i Strehimit u mblodh më datën 23.06.2025 i përbere nga 7 anëtare . Pasi morri në shqyrtim 2 aplikimet dhe dokumentacionin e aplikuesve konstatoi se familjet:

1. Znj/ Elona Uzhuri përbëhet nga dy anëtarë: vetë aplikanti dhe vajza . E punësuar në sektorin shtetëror dhe përfiton të ardhur mujore në vlerën 68,922 lekë. Aktualisht, familja nuk zotëron asnjë banesë në pronësi dhe për këtë arsye gjendet në kushtet e nevojës për përfitim nga programet e strehimit social.Duke marrë parasysh përbërjen familjare, nivelin e të ardhurave dhe mungesën e një banese në pronësi, familja e Znj. Elona Uzhuri përmbush kriteret për t'u trajtuar me prioritet në skemat e mbështetjes për strehim, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.Komisioni e vlerësoi me 24 pikë .

2. Z/ Mikel Ahmetli përbëhet nga katër anëtarë: aplikanti bashkëshortja dhe dy femijet e tij. Të dy janë të punësuar në sektorin privat dhe përfitojnë të ardhura mujore në vlerën 80,501 lekë .Aktualisht, familja nuk zotëron asnjë banesë në pronësi dhe për këtë arsye gjendet në kushtet e nevojës për përfitim nga programet e strehimit social.Duke marrë parasysh përbërjen familjare, nivelin e të ardhurave dhe mungesën e një banese në pronësi, familja e Z. Mikel Ahmetli i përmbush kriteret për t'u trajtuar me prioritet në skemat e mbështetjes për strehim, sipas

përcaktimeve ligjore në fuqi.Komisioni e vleresoi me 24 pikë sipas Sistemit të pikëzimit bazuar VKB Nr.101 datë 24.12.2021 "*Mbi miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social, të ardhurave minimale që duhet të kenë familjet përfituese të banesës me kosto të ulët ndërtuar nga EKB si dhe nivelit maksimal të subvencionit të qirasë*".

Aplikimet për këtë program Strehimi do të qëndrojnë të hapura deri në plotësimin e të gjitha kuotave që na janë akorduar nga Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Konceptoi:Spec e Administrimit të Nevojave për Strehim
Linda Laci
Miratoi :Përgjegjës i Sektorit të Kujdesit Social dhe PAK
M.Bejleri
Konfirmoi: Drejtor i Shërbimeve Sociale
Zerina Sinani

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

KOMISIONI I STREHIMIT

VENDIM
Nr.01 datë 23.06.2025
MBI
MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI SUBVENCIONI I INTERESAVE TË KREDISË PËR STREHIM

Bazuar ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*" i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, VKM nr.384, datë 12.6.2019 "*Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore*", VKM nr.453, datë 03.07.2019 "*Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet, që përfitojnë banesë me kosto të ulët , me kredi të lehtësuara nga shteti*" *ndryshuar me vendimin nr. 268, datë 29.4.2022*, VKM nr.301 datë 15.4.2020 "*Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët*", VKB Nr.17, datë 27.02.2025 "*Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit*",nivelit minimal dhe maksimalte te te ardhurave dhe dokumentacionit kredi te lehtesuar nga shteti qe duhet te plotesojne individët/familjet për tu trajtuar me programin e subvencionimit. VKB nr.2 datë 29.01.2025 për "*Miratimin e rregullores dhe funksionimin e komisionit të strehimit në bashkinë Devoll*" , Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.37 datë 25.01.2024 "*Për ngritjen e komisionit të strehimit pranë bashkisë Devoll*"
Komisioni i Strehimit:

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e përfituesve për programin Subvencioni i Interesave të Kredisë për strehim, sipas tabelës Nr.1 bashkëngjitur këtij Vendimi;

2. Ngarkohet Zyra e Strehimit:
   a) të përgatisë Projekt-Vendimin për t'u paraqitur në Këshillin Bashkiak, bazuar këtij Vendimi;
   b) të njoftojë familjen përfituese;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Aneksi nr. 1 - Formula e Pikëzimit për programin e strehimit social "Subvencionimi i interesave të kredisë"

	SISTEMI I PIKËZIMIT PËR TRAJTIMIN SIPAS PROGRAMIT "SUBVENCIONI I INTERESAVE TË KREDISË"	Pikët
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	25
I.	Nuk disponon banesë në pronësi	9
II.	Banesa në rrezik shembje	3
III.	Banojnë në banesa të mbi populluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;	3
IV.	Kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastrehë, si rezultat i Fatkeqësive natyrore;	3
V.	Familje ose individë që humbasin banesën e tyre si pasojë e zhvendosjes ose e zbatimit të një vendimi gjyqësor	4
VI.	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat I investimeve publike;	3
1.2	KUSHTET FAMILJARE	25
I.	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë; ku përfshihen dhe vajzat nëna;	6
II.	Të moshuarit që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t`u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;	2
III.	Familjet me më shumë se katër fëmijë;	5
IV.	Familjet e reja, ku mosha e anëtarit më të madh të familjes në momentin e kërkesës të jetë më e vogël ose baraz me 40 vjeç.	6
V.	Të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç.	6
1.3	KUSHTET SOCIALE	25
I.	Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave	4
II.	Individë me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror e deri në moshën 30 vjeç;	4
III.	Familje e mbetur e pastrehë për shkak të lirimit të banesave të ish-pronarëve.	1

IV.	Emigrantë i rikthyer, punëtorë emigrantë dhe azilkërkuesit, refugjatë apo personat me mbrojtje plotësuese;	2
V.	Familjet e policëve të rënë në detyrë	2
VI.	Punonjës i repartit të ndërhyrjes së shpejtë FNSH Punonjës i repartit RENEA Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin	4
VII.	Viktimë e trafikimit ose viktimë e mundshme të trafikimit.	3
VIII.	Anëtar e komunitetit Rom dhe Egjiptian	3
IX.	I mitur në konflikt me ligjin sipas parashikime vetë Kodit Të Drejtësisë Penale për të mitur,	1
X.	Individë që i përket komunitetit LGBTI,	1
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	25
i.	Familje me të ardhura mesatare që janë familjet me të ardhura mujore midis 100 dhe 120 për qind e të ardhurave mesatare;	9
ii.	Familje me të ardhura të ulëta, që janë familjet me të ardhura mujore midis 70 dhe 100 për qind e të ardhurave mesat are	9
iii.	familje me të ardhura shumë të ulëta, që janë familjet me të ardhura mujore më të ulëta se 70 për qind e të ardhurave mesatare	7
iv.	Familje pa të ardhura	0
	TOTALI PIKË	100

Në total sistemi i pikëzimit përmban 100 pikë, ku çdo kriter përmban 25 pikë.

Kushtet ekonomike, në bazë të të cilave grupohen familjet, sipas të të ardhurave përcaktohen bazuar në të dhënat e përditësuara të Instituti të Statistikave (INSTAT) sipas nenit 2, pikës 45 të ligjit 22/2018 "Për strehimin Social" i ndryshuar.

abela Nr.1 lista e përfituesve të programit të Strehimit Social, Subvencioni i Interesave të Kredisë.

Nr.	Emri/Atësia/ Mbiemri	Pikë	Përbërja familjare	Struktura e apartamentit që përfiton	Kushtet e Strehimit (shkronja "a", e nenit 16)	Kushtet familjare (shkronja "b", e nenit 16)	Kushtet sociale (shkronja "c", e nenit 16)	Të ardhurat mujore neto të familjes/lekë	Punësimi	Kredia Maksimale që përfiton
1.	Elona Emin Uzhuri	30	2	1+1	Nuk ka banesë në pronësi	-	Nene e vetme qe ka ne ngarkim femije	68.922	Shtet	2.211.000
2.	Mikel Hekuran Ahmetli	24	4	2+1	Nuk ka banesë në pronësi	-	-	80.501	Privat	3.256.200

KOMISIONI I STREHIMIT

1. Linda Nocaj
2. Ruan Shano
3. Ylson Shaqa
4.
5. Qerber Duxhi
6. TATJANA SAHKO
7. Ervisela Kuka

KRYETAR I KOMISIONIT

Zerina Sinani

Tabela nr. 2- MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI SUBVENCIONI I INTERESAVE TË KREDISË PËR STREHIM

Nr. Rendor	Emri/Atësia/Mbiemri	Perberja familare sipas çertifikates fam gjendja aktuale	Struktura e apartamentit qe perfiton	Kushtet e strehimit sipas (shkronja " a" neni 16)	Kushtet familjare sipas (shkronja " b" neni 16)	Kushtet sociale sipas (shkronja " c" neni 16)	Te ardhurat mujore neto te familjes	Punesimi	Vlera max e perfitimit te kredise
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	Elona Emin Uzhuri	2	1+1	Nuk disponojne banese në pronësi		Nënë e vetme që ka në ngarkim femijë	68 922	Punësuar në Shtet	2 211 000
2	Mikel Hekuran Ahmetli	4	2+1	Nuk disponojne banese në pronësi			80 501	Punësuar në Privat	3 256 200

KRYETARI I BASHKISË
EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL